

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË****BORDI****VENDIM****Nr. 184, Datë 10.11.2017****MBI****REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË MTC ENERGY SH.P.K. PËR
TRANSFERIMIN E ASETEVE PRANË RAIFFEISEN BANK, PËR EFEKT TË
RISTRUKTURIMIT TË KREDISË**

Në mbështetje të neneve 16; 20 pika “a” dhe 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe ne zbatim te neneve 7 dhe 11 të “Rregullores per procedurat e transferimit të aseteve nga të licensuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” gjithashtu dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi refuzimin e transferimit të aseteve të shoqërisë MTC Energy sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Bordi i ERE me vendimin nr.101, datë 04.07.2017 filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy“ sh.p.k, për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Raiffeisen Bank” sh.a.

Në vijim të vendimarrjes sipërcituar, ERE njoftoi shoqërinë “M.T.C Energy“ sh.p.k, me shkresën nr.158/1 Prot., datë 21.09.2017, për detyrimin e plotësimit të dokumentacionit të munguar brenda 15 ditësh.

Edhe pas kalimit të këtij afati, rezulton se subjekti ende nuk ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm në pajtim me nenin 7 pika 1 të “Rregullores per procedurat e transferimit të aseteve nga të licensuarit”.

Mungesa e dokumentacionin konsiston si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gërmat: “c” gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve; “f” efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licensuarit ; “g” efektin në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licensuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licensuar;
- Neni 7 pika 3. (Subjektet koncencionare te licensuar, te cilet aplikojne per miratimin e transferimit te aseteve ne ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit te aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të

marreveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Autoriteti shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë MTC Energy sh.p.k. për transferimin e aseteve pranë Raiffeisen Bank, për efekt të ristrukturimit të kredisë.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI